

VENDIM
Nr. 238, datë 14.4.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË 3 (TRI) OBJEKTEVE NË BASHKINË MIRDITË DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve në Bashkinë Mirditë, në masën 108 617 578 (njëqind e tetë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mirditë (ish-kinemaja), në masën 25 244 079 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

b) rikonstruksionin e ish-godinës së Bashkisë Mirditë, në masën 58 438 651 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

c) rikonstruksionin e godinës së Muzeut Historik, Mirditë, në masën 24 934 848 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Mirditë, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 21 723 515 (njëzet e një milionë e shtatëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve, në Bashkinë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mirditë (ish-kinemaja), në masën 5 048 815 (pesë milionë e dyzet e tetë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) rikonstruksionin e ish-godinës së Bashkisë Mirditë, në masën 11 687 730 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH;

c) rikonstruksionin e godinës së Muzeut Historik, Mirditë, në masën 4 986 969 (katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe